

UDHËZIM
Nr. 5, datë 1.4.2022

**MBI KËRKESAT PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT PËR KONSUMATORËT,
PËR MUNGESËN OSE PRANINË E REDUKTUAR TË GLUTENIT NË USHQIM¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës dhe nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi dhe lënda

Ky udhëzim zbatohet për dhënien e informacionit për konsumatorët për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) “gluten” nënkupton një fraksion proteine nga gruri, thekra, elbi, tërshëra ose varietetet e tyre të kryqëzuara dhe derivatet e tyre, i cili është i patretshëm në ujë dhe në solucion 0,5 M klorur natriumi, ndaj të cilit persona të caktuar janë intolerantë;
- b) “gruri” nënkupton çdo specie *Triticum*.

Neni 3
Informacion për konsumatorët

1. Kur deklaratat përdoren për t’u dhënë informacion konsumatorëve për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim, një informacion i tillë jepet vetëm nëpërmjet deklaratave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në shtojcë.

2. Informacioni i ushqimit të përmendur në paragrafin 1 mund të shoqërohet me thëniet: “i përshtatshëm për personat intolerantë ndaj glutenit” ose “i përshtatshëm për sëmundjet celiake”.

3. Informacioni i ushqimit të përmendur në paragrafin 1 mund të shoqërohet me thëniet: “i formuluar në mënyrë specifike për njerëzit intolerantë ndaj glutenit” ose “i formuluar posaçërisht për sëmundjet celiake”, nëse ushqimi është prodhuar, përgatitur dhe/ose përpunuar posaçërisht për të:

- a) zvogëluar përmbajtjen e glutenit të një ose më shumë përbërësve që përmbajnë gluten; ose
- b) zëvendësuar përbërësit që përmbajnë gluten me përbërës të tjerë që në formën e tyre natyrale nuk përmbajnë gluten.

Neni 4
Formulat për foshnjat dhe format pasuese

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 828/2014, të datës 30 korrik 2014, “Mbi kërkesat për dhënien e informacionit për konsumatorët për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim”.

Ndalohet dhënia e informacionit ushqimor për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në formulat për foshnjat dhe formulat pasuese, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 20, datë 22.11.2021, “Për ushqimin për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, ushqimin për qëllime të veçanta mjekësore dhe zëvendësuesit e dietës totale për kontrollin e peshës”.

Neni 5
Dispozita të fundit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA
DEKLARATAT QË LEJOHEN TË BËHEN PËR MUNGESËN OSE PRANINË E
REDUKTUAR TË GLUTENIT NË USHQIME DHE KUSHTET E TYRE

A. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

PA GLUTEN

Deklarata “pa gluten” mund të bëhet vetëm kur ushqimi i shitur te konsumatori i fundit nuk përmban më shumë se 20 mg/kg gluten.

GLUTEN SHUMË I ULËT

Deklarata “gluten shumë i ulët” mund të bëhet vetëm kur ushqimi, i përbërë ose që përmban një ose më shumë përbërës të prodhuar nga gruri, thekra, elbi, tërshëra ose varietetet e tyre të kryqëzuara, që janë përpunuar posaçërisht për të reduktuar përmbajtjen e glutenit, nuk përmban më shumë se 100 mg/kg gluten, kur i shitet konsumatorit të fundit.

B. KËRKESA SHITESË PËR USHQIMIN QË PËRMBAN TËRSHËRË

Tërshëra e përmbajtur, në një ushqim të paraqitur si pa gluten ose me gluten shumë të ulët, duhet të jetë prodhuar, përgatitur dhe/ose përpunuar posaçërisht në një mënyrë për të shmangur kontaminimin nga gruri, thekra, elbi ose varietetet e tyre të kryqëzuara dhe përmbajtja e glutenit të tërshërës në të nuk mund të tejkalojë 20 mg/kg.